

L I G J
Nr. 8719, datë 19.12.2000

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8449, DATË 27.1.1999, “KODI DOGANOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8473, DATË 14.4.1999**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në pikën 4 të nenit 37 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8473, datë 14.4.1999, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje:

“c) Pagesat për të drejtën e pronësisë intelektuale (royalties) dhe për të drejtën e licencës (licence fee) për filmat kinematografikë të importuar në Republikën e Shqipërisë me të drejtën e riprodhimit dhe të shpërndarjes, nuk do t’i shtohen çmimit realisht të paguar ose që duhet paguar.”

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2842, datë 23.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**